



## KUVENDI I KOMUNËS KLINË

Shërbimi për Punë të Kuvendit

01 Nr. 06- 4470/14

Klinë, më 29. 08. 2014

17.10.2014

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e VII-të e radhës të Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datën 29. 08. 2014, në sallën e Kuvendit të Komunës, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje ishin prezent: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i Kuvendit, Haxhi Ibishi, nënkyetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e Kuvendit të Komunës, drejtoret e drejtive, përfaqësues të OSBE-se, të Policisë së Kosovës, KFOR-it , të Zyrës Ligjore, mediet e tjera.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Z. Haxhi Ibishi, i cili pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit i lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në këtë mbledhje dhe propozoi që në pikën e rendit. "Në pikën, Të ndryshme, kemi një kërkesë për zëvendësimin e një anëtarë të komisionit për evidentimin e rrugëve të fshatrave dhe atë me propozim të ekzekutivit duhet të zëvendësohet një anëtar, prandaj ju kisha lutar që ta përfshimë si pikë të rendit të ditës në Të ndryshme, thjesht për urgjencën e kohës, për arsy se ata kanë për të dale prej muajit shtator në terren", theksoi Kryesuesi Ibishi i cili në vijim hapi debatin rreth rendit të ditës.

Fadil Gashi, theksoi se te pika e fundit e rendit të ditës, Të ndryshme ne kemi një kërkesë, ku kërkojmë prej ekzekutivit që në seancën e radhës të na kompletojnë me dokumentacion rreth Fabrikës së ujit, duke përfshirë kontratën që është bërë me kompaninë dhe gjitha pagesat në vazhdimësi sipas situacioneve që iu ka bërë operatorit që ka kryer punët dhe deri sot që nuk është lëshuar ajo fabrikë në përdorim. Kjo është arsyaja e kërkesës në Të ndryshme.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e propozuar të ditës me gjithë kërkesën e GP të LDK-së që në seancën e ardhshme të ketë edhe një pikë shtesë të rendit të ditës rreth Fabrikës së ujit dhe me propozimin tim që të hyjë me zëvendësimin e një anëtarë nga ekzekutivi për emërtimin e rrugëve.

Me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit u miratua ky

R e n d i i d i t ë s

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,

3. Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së,
4. Shqyrtimi i procesit nga takimi me publikun i dt. 30.06.2014,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimeve dhe plotësimave të Rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënien në diskutim publik të Draft-programit trevjeçar të banimit social për përudhen 2013-2016,
7. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës të dt. 09. 07. 2014 lidhur me miratimin paraprak të Vendimit për dhënie të pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së ngushtë për anëtarësim në komitetet konsultative sipas Vendimit te KK-se dhe konkursit të shpallur,
9. Interpelancë e Drejtorit të Shëndetësisë për gjendjen në shëndetësi,
10. Të ndryshme.

*Pika e I-rë: Arsyetimi i mungesave.*

Dr. Haxhi Ibishi, tha se kam konfirmim nga Ndue Shabanaj,i cili ka rast vdekjeje të cilin e ngushëllojmë në emrin tim dhe në emrin tuaj dhe Marije Selmanaj, ecila është jashtë Kosovës me arsy, për mungesa tjera nuk kam ndonjë arsyetim.

*Pika e II-të: Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar.*

Kryesuesi hapi debatin rrëth procesverbalit. Nuk pati debate. Kryesuesi e vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Procesi i mbledhjes së kaluar u miratua unanimisht nga anëtarët e Kuvendit.

*Pika e III-të: Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së.*

Haxhi Ibishi, tha se në KPF po trajtohen të gjitha ato kërkesa të qytetarëve dhe grupeve të organizmit dhe në një farë forme po jepet një preferencë nga KPF. “Ju me kohë keni marrë materialin, hapi diskutimin nëse dikush ka diçka rrëth ndonjë preference që ka dhënë komiteti. Kryesuesi hapi debatin.

Avni Gashi, tha së lidhur me preferencat e KPF-se kam vërejtje në pikën e parë, ku thuhet se qytetarët për çdo projekt duhet të participojnë me shumën e mjeteve financiare prej 30% . “Kjo më duket e padrejtë dhe e paqartë, sepse fillimisht duhet të sqarohet shumë që ka për tas marrë pjesë dhe shumë gjera tjera dhe shuma është shumë e madhe, që nuk mund të realizohet. Është ky në një vendim të KK, a ka qenë ai vendim i KK,apo është praktikë dhe preferohet të participojmë me një shumë të tillë për të hyrë në prioritet një projekt”, shtoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, sqaroi se ka qenë vendim i këtij kuvendi, por në disa raste ekzekutivi duke i parë arsyeshmërinë e kërkesave e ka zbritur atë kuotë.”Unë po pajtohem për këtë vërejtjen që ju e thatë, por në një farë forme është edhe në ekstraktin e procesverbalit që kemi këtu”, shtoi kryesuesi.

**Skënder Merturi**, tha se edhe unë isha ndalë te 30 përqindëshi, siç u tha është shumë kur kemi parasysh se disa Komuna e kanë hequr tërësisht participimin.” Nëse qytetarët paguajnë taksa Komunës, edhe taksa të tjera, atëherë pse po i shtohet edhe një barrë prej 30 për qind. Në seancë të mëhershme të AK-së Kryetari i Komunës e ka përmend 20 për qind, tash në seancën e fundit u rritë 30 për qind, është vërtet tepër, prandaj kisha thënë që të marrim shembull komunat tjera në mënyrë që ta heqim krejt, edhe pse e di situata qysh është”, pohoi anëtarin Merturi.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi anëtarin Merturi, se ky vendim është legjitim dhe i marrë me kohë bukur moti, të cilin vendim mund ta rishikojmë dhe ta rivendosim ashtu siç është më së miri.

**Halil Desku**, pohoi se ne jemi duke folur për procesverbalin e takimit me qytetarë dhe kur një përgjigje të tillë e ka dhënë drejtori i Financave dhe ai është thirrur në atë vendim. “Domethënë ne nuk e kemi ne diskutim këtë vendim, mirëpo procesverbalin. Mendoj se nuk mund të them se nuk është e drejtë se çfarë kërkojnë këta dy parafolësit, por në një të ardhme kur ne kemi për të biseduar kemi për të pasur kërkesa të tilla. Andaj, të kalojmë dhe të procedojmë sipas rendit të ditës”, theksoi prof. Desku.

Vuri në miratim preferencat e KPF-së.

**Preferencat e KPF-se u miratuan nga anëtarët e Kuvendit.**

*Pika e IV-të: Shqyrtimi dhe miratimi i procesit nga takimi me publikun i dt. 12.06.2014.*

Kryesuesi hapi diskutimin.

**Haxhi Ibishi**, tha se në KPF e kemi aprovuar këtë procesverbal dhe brenda atyre pikave ka qenë edhe kjo që u debatua.

Procesi i debatit me publikun mbi rrjedhat e qeverisjes në Komunë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 u miratua unanimisht.

*Pika e V-të: Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimeve për plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale.*

**Haxhi Ibishi**, mendoj këtë çështje e kemi shterë shumëdimensionalist dhe thjesht kemi ardhur në një propozim i cili ka marrë miratimin e gjithë anëtarëve të KPF-së dhe konsideroj që edhe këtu ajo frymë do të bartet. Në vijim kryesuesi hapi diskutimin rrethe rendit të ditës.

**Avni Gashi**, tha se çështje është një nga më të rëndësishme dhe me interes për qytetarët. “Te neni 10 te vendimi që është marrë është lënë hapësirë që nuk përkon me realitetin sa i përket eksploatimit të zhavorrit. Unë për vete kam vërejtje, sepse thuhet që (lexoi nenin). Nëse analizojmë këto fjala atëherë çka të ndodhë me ata që eksploatojnë. Domethënë i merr 20 kamionë dhe 1 prej tyre e japim, domethënë është diçka që nuk

përkon me realitetin, apo iu krijojmë hapësirë me vendime komunale për ta përdorur zhavorrin. Mendoj që komplet është e pavend, sepse mendoj se duhet paguar tërë dëmin nëse duam ta ndalim eksploatimin e zhavorrit në mënyrë ilegale. Ndërsa një element tjeter që është cekur me UA të MMPH që zëvendëson shumë rregullore dhe shumë tarifa, por këtë UA unë jam munduar ta gjej por nuk e kam. Ndërsa te pikë 59 që kam pasur një shqetësim, prapë nuk e kam gjetur, sepse nuk është e fotokopjuar mirë dhe nuk e di nëse ka zëvendësuar fjalën “ditore” dhe “mujore” mes vete”, nën vizoi anëtarë Gashi.

**Fadil Gashi**, tha se është debatuar boll, mirëpo ka zbrazëti, sepse nuk është plotësuar me çmimet e propozuara. “Fjala vjen te shfrytëzimi i Qendrës së Kulturës “Jehona e Dukagjinit”, te koncertet, filmat etj., nuk ka dhënë çmime, ne miratojmë një rregullore, ndërsa nuk e dimë sa është çmimi tash, së është lënë zbrazët aty, ndërsa për aktivitete tjera caktohet tarifa prej 20 euro për 1 orë”, shtoi anëtarë Gashi, i cili në vijim tha se unë kisha propozuar që për tubime politike me qenë 50 euro, ndërsa për shfaqje të ndryshme, koncerete etj., me qenë 100 euro, dhe këtë 20 euro për 1 orë është mirë për të na hartuar hartuesi çfarë ka menduar dhe për cilat aktivitete mendohet, sepse kemi aktivitete të shumta, aktivitete komemorative, akademi etj., që janë gjera që duhet planifikuar, se a duhet për t'i liruar apo për t'ua qitur këtë takës”, pohoi anëtarë Gashi.

**Halil Desku**, tha se unë apeloj tek hartuesi, konsideroj se Zyra ligjore është marrë dhe i ka lexuar ligjet, domethënë gjithçka për të qenë konform ligjit. “Nëse vërtetë në ligj shënon ndalohet eksploatimi i zhavorrit dhe degradimi i lumenjve, që është një temë që kemi diskutuar edhe më herët. Konsideroj se kjo është një veprimtari e ndaluar dhe nuk bëhet fjalë për gjobë ose jo gjobë, për t'ia marrë zhavorrin apo për të mos ia marrë. Duhet një formulim i ri, sinqerisht po e them se është në pyetje degradimi i lumenjve dhe kjo është e ndaluar me ligj”, shtoi prof. Desku.

**Kristina Lazri**, sqaroi çështjet që kanë të bëjnë me Drejtorinë për Kulturës Rini e Sport.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes në debatim. Kryesuesi Ibishi tha se pajtohem me propozimin Fadilit që për tubimet e partive politike që shuma prej 100 euro të zbritet në 50 €. “Partitë politike janë të organizuara për këtë popullsi, për këta njerëz tanë, thjesht ne duhet t'i shikojmë edhe fondet e tyre”, shtoi ndër të tjera kryesuesi.

**Kolë Prenaj**, drejtor i Inspektoratit, sqaroi shumë çështje që kanë të bëjnë rreth çështjes në debat, përkatësisht rreth eksploatimit të zhavorrit dhe degradimit të lumenjve. Drejtori Prenaj, sqaroi edhe shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë rreth Drejtorisë së Inspektimit, që kanë të bëjnë me temën bosht.

**Driton Raci**, zyrtar i Zyrës komunale ligjore, foli për shumë çështje të ngritura nga anëtarët rreth çështjeve në debat.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth sqarimeve dhe propozimeve që dhanë anëtarët e KK dhe drejtorët e ekzekutivit.

**Fadil Gashi**, tha se nëse shkohet te kjo pjesa e tretë, te këto 20 euro për orë, te ky precizohen aktivitete, po ashtu edhe ato të tjera që lirohen, është mirë për t'i sankzionuar,

për t'ua vënë emrin aty.”E dyta, po del ndesh ajo që thotë zyrtari ligjor se anëtarët e KK e kanë kërkuar këtë zbrazëtirë. Udhëzimet që vinë prej së larti ne nuk mund t'i ndryshojmë, nëse është udhëzim le të mbetet udhëzim. Ne duhet vetë për t'i përcaktuar, duhet sanksionuar sepse kjo është rregullore”, shtoi ndër të tjera anëtarë Gashi.

**Halil Desku**, tha që së pari jam që këtu të mos votohen në paket, por veç e veç edhe të debatohen edhe të votohen, sepse kemi dallime në diskutim. “Për tubimet politike nuk jam që të zbritet asnjë cent, sepse është fjala për tubime politike, edhe këto janë në 4 vjet. Për pikën e dytë, për shfaqje të ndryshme, këtu është fjala për ngritjen e nivelit kulturor të qytetarëve tanë dhe jam në dakord që tarifa të jetë sa më e ulët dhe të jetë ajo që kemi propozuar, sepse këtu përfitojnë qytetarët tanë. Të aktivitetet 20 euro dakordohem me Fadilin, sepse konsideroj se duhet pasur edhe falas krejt dhe është mirë të dihen cilat aktivitete paguhen dhe cilat lëshohen falas”, tha anëtarë Desku dhe tha se e mbështes, i cili në vazhdim foli edhe rreth çështjes së zhavorrit dhe degradimit të lumenjve”, tha prof. Desku.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes në debat.”Edhe partive politike ua dimë bazën financiare që kanë”, shtoi kryesuesi.

**Arben Limani**, te kjo pika që po diskutohet, shfaqjet teatrale, te koncertet, ndoshta do të kishte qenë mirë të na ishte sqaruar edhe Zyra Ligjore, edhe drejtoresha e Kulturës, se këtu bëhet fjalë më shumë për shoqata dhe ansamblet të cilat vijnë nga jashtë. “Ata ne duhet për t'i ngarkuar me këtë tarifë. Nëse filmin e lëshon drejtoria, i bëjmë ne pajisjet, nuk vlen ky 20 për qind, sepse ato mjete i ngarkohen për krejt drejtorinë përkatëse, ose nëpër komuna në veçanti. Ma merr mendja që kjo do përkufizim tjetër”, tha anëtarë Limani.

**Skënder Merturi**, vlerësoi se nuk mund ta lëmë me 20 për qind sepse mund të ketë edhe keqpërdorim aty. “Të caktojmë 10, 15, 20 euro, ta caktojmë një shumë të mos e lëmë në atë që sa shiten biletat paguaj, sepse ka mundësi për keqpërdorim të biletave ose te partitë politikë shumë të mos jetë 100 euro, por 50 euro”, shtoi ai.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se po shihet është një pajtueshmëri e të gjithëve se kjo takse komunale duhet të ekzistojë. ”Për hir azhuritetit ju kisha kërkuar të mos merremi me cikërimi, sepse vetë fakti, siç tha Fadili të sanksionohen kategoritë të cilat lirohen, i bashkëngjiten në pikën 3, këto kategori të bashkëngjiten në atë pikë, për tubime politike mbet 100 ose 50 euro merremi vesh për shfaqje është 20 për qind. Ky Udhëzim Administrativ që është ardhur prej Kryarkivistit qendror është thjeshtë udhëzim administrativ, të cilën Komuna është e obliguar për ta zbatuar”, shtoi Kryesuesi.

**Prend Buzhala**, shtoi se kisha dëshiruar që këto udhëzime kur kërkohen është mirë të na vinë, domethënë ne t'i kem, e para. “E dyta, nëse partitë politike, i mbushin xhepat e hoteleve me pare është mirë edhe Komunën ta ndihmojnë”, shtoi prof. Buzhala.

**Tunë Dedaj**, tha se desha vetëm në dy gjera për t'u ndalë rreth partive politike.”Nëpër hotele ne paguajmë shumë më shumë dhashtë zoti të mos formohen shumë parti politike, sepse nuk do të kenë mjete për ta paguar sallën. Ndërsa te çështja që potencoi Skënderi,

aty është mirë për të qenë 20 për qind e fitimit, aty mund të shiten vetëm 5 biletat, qysh do t'i thuash m'i jep 20 euro”, tha anëtari Dedaj.

**Avni Gashi**, tha se kisha propozuar që për tubime politike 100 euro, për 2 orë.

**Qamile Qitaku**, kisha propozuar që në listën ku lirohen të hynë edhe aktivitetet e fëmijëve, humanitare dhe aktivitetet me karakter edukativ.

**Fadil Gashi**, theksoi se veç për hir të opinionit dhe gjithë anëtarëve të KK, nëse ne thirremi në komunat tjera duhet për ta ditur se diku 80 për qind të komunave i paguajnë qiratë e zyrave të partive politike. “Nuk është problem me LDK-në, se e mbulojmë këtë pjesë, por është për subjekte të tjera që nuk janë në gjendje t'i mbulojnë këto shpenzime. Edhe në Komunën e Klinës, në të kaluarën partitë politike për zyrat e tyre nuk kanë paguar as qira as shërbimet të tjera, si të mbeturinave etj., të gjitha i ka paguar Komuna. Unë jam për cilindo variant, mirëpo ne nuk mund të krahasohemi me komunat tjera, sepse shumë nga to janë në gjendje partive politike t'i paguajnë këto shpenzime. E dyta, secili subjekt politik që nesër e bën kërkosë mund të zhvillojë në këtë sallë aktivitet pa pagesë, sepse është obligim ligjor i Komunës për t'u mundësuar se cilës parti për ta shfrytëzuar këtë sallë, sepse kjo sallë është e të gjithëve. Nuk është diçka absurde që unë po kërkoj këtë, edhe jo vetëm për një subjekt por për të gjitha subjektet politike dhe është për të mirën e tyre dhe veprimtarisë së tyre, jo që s'mundem për ta mbuluar, as ne as partitë tjera, mirëpo ne e tregojmë një shembull, sepse kemi obligim karshi subjekteve politike që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Klinë”, nën vizoi anëtari Gashi.

**Prend Buzhala**, desha një sqarim, kur thashë: “mbase i paguajnë hotelet”.”Me këtë rast kisha fjalën që këtu të mos lirohet, sepse çmim nuk kam caktuar”, sqaroi prof. Buzhala.

**Kristina Lazri**, theksoi se ne mendojmë së shumat e propozuara nuk janë të larta dhe shtoi së për tarifat e arkivit janë ngritur çmimet.

**Hali Desku**, tha se ne folën shumë për organizimin politik, dhe folëm sikur jemi duke ndërtuar një rregullore për funksionimin e partive politike lokale. “Dhe, ndoshta do të kishte për të qenë mirë nëse lejohet për ta pasur një rregullore për funksionimin e partive politike në nivel lokal. Mendoj që ishte e qëlluar atë që tha Fadili, se partive politike duhet krijuar hapësira”, pohoi prof. Desku.

**Driton Raci**, përf. i Zyrës Ligjore të Komunës dha sqarime shtesë për ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se jemi duke rrahur në të njëjtat valë. Vuri në miratim ndryshimin e rregullores.

**Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për taksa u miratuan unanimisht nga anëtarët e Kuvendit.**

**Pika e VI-të: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për vuarje në diskutim publik të Draft-programit trevjeçar të banimit social për vitet 2013-2016.**

Kryesuesi foli rreth propozim-vendimit. Hapi diskutimin.

**Arben Limani**, tha se do të kishte qenë mirë që kur na prezantohen si draft-programe ose dokumente të tjera të bëhet praktikë për takimet tjera që këto dokumente të prezantohen prej ekzekutivit dhe të bëhet një prezantim i shkurtër, një elaborim, ose një sqarim nga drejtoria përkatëse mbi arsyeshmërinë e atij dokumenti, gjegjësisht atij draft-programi, sepse është bukur një material voluminoz. “Do të kishte qenë mirë të na jepen sqarime më detale”, vlerësoi anëtari Limani.

**Qamile Qitaku**, tha se këtu po shkruan” “për vuarje në diskutim publik”, a duhet të hapim debat.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi çështjen dhe tha se ky propozim-vendim është propozuar që nga Kuvendi të vihet ne diskutim publik dhe ne së bashku do të debatojmë për këtë.”Kjo është dashur shumë më herët për t'u kryer. Kjo thjeshtë është procedurë, prandaj kur vjen për miratim, edhe në KPF do ta diskutojmë, edhe në Kuvend këtu, edhe drejtoria gjegjëse do të na jep sqarime plotësuese”, shtoi Kryesuesi.

**Propozim-vendimi u hodh në votim dhe u miratua unanimisht.**

**Pika e VII-të: Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës të dt. 09.07.2014 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale.**

**Rexhep Rexhepi** (zyrtar në Drejtorinë e Bujqësisë), dha sqarime për propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër.

**Skënder Merturi** tha së mungesa e një strategjie zhvillimore e shtyn Komunën që ta jep pronën e pa luajtshme në shfrytëzim dhe me këtë unë nuk pajtohem, edhe nga komiteti për pronë Kuvendi e ka marrë një rekomandim me te cilin kërkohet që prona komunale mos të epet në shfrytëzim pa u konsultuar paraprakisht me këtë komitet.

**Halil Desku**, tha se dhënia e pronës në shfrytëzim nga Komuna është konform ligjit dhe ne e përkrahim, dhe mendoj se Komiteti për Pronë i ka tejkaluar kompetencat e veta, sepse në i kemi shqyrtuar rekomandimet e juaja.

**Avni Gashi**, tha se këto çështje jepen me tenderim dhe mendoj se Komiteti për Pronë ka të drejtë.

**Qamile Çitaku**, tha së Kuvendi duhet të përkrah këtë propozim, sepse këtu bëhet fjalë edhe për zhvillim të biznesit.

**Rexhep Rexhepi**, theksoi se bëhet fjalë për dy punkte në të cilat ka investuar Komuna. Në vijim zyrtari Rexhepi dha arsyetime të tjera shtesë.

**Ky Propozim-vendim u hodh në votim dhe propozim Vendimi u miratua.**

**Pika e VIII-të: Shqyrtimi dhe miratimi i listës së ngushtë për anëtarësim në Komitetet konsultative.**

Rasim Millaku, në cilësinë e kryetarit të komisionit për anëtarësim në Komitetet konsultative i lexoi emrat e kandidatëve të përzgjedhur për të dy këto komitete.

Kryetari i Komisionit për anëtarësim në Komitetet Konsultative kërkoi që të përkrahen këto komitete dhe anëtarëve të Komiteteve Konsultative t'u kompensohen mëditjet.

Në vazhdim kryetari i Komisionit, z. Millaku, prezantoi listën e ngushtë të anëtarëve të Komiteteve Konsultative.

**Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrotje të Mjedisit:**

1. Luigj Gojani, Klinë
2. Marte Selitaj, Klinë
3. Linda Dedaj, Qeskovë
4. Behar Racaj, Siqevë
5. Patrik Gjergjaj Krushevë e Vogël

**Komiteti për Çështje Emergjente:**

1. Betim Elezaj, Klinë
2. Adem Gashi, Përqevë
3. Fatmirë Fazliu, Grabanicë
4. Mërgim Musa, Poterq i Epërm
5. Ilir Mehmeti, Bokshiq

**Lista e ngushtë e Komiteteve Konsultative u hodh në votim dhe u miratua unanimisht.**

**Pika e IX-të: Interpelanca e drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë.**

Haxhi Ibishi, tha së kjo interpelancë e drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë është kërkuar nga Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i KK, dhe praktikë është që ata që kanë kërkuar interpelancën t'u jepet një fjalë.

Filloreta Berisha, tha se në emër të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i kemi kërkuar drejtorit interpelancë, është kërkuar më herët, megjithatë nuk ka ndonjë problem që kjo interpelancë po mbahet me vonesë, për mua nuk ka problem për materialin, sepse i di problemet në shëndetësi, drejtori nuk na ka pajisur me dokument të cilin është dashur ne të posedojmë këtu përpara për të diskutuar. "Sidoqoftë, unë do t'ia parashtroj pyetjet që ia ka parashtruar komisioni se çka kemi kërkuar prej drejtorit për shëndetësi. Pyetja e parë ka qenë rreth gjendjen në QKMF, pikërisht ne Emergjencë, ku gjatë një vizite që i kemi bërë në fundin e muajit prill apo maj, ka qenë një gjendje e tmerrshme mund të them edhe e mjerueshme. Nën dy, mospagesa e kujdestarive të natës, për 6 vite radhazi nuk është kryer nga QKMF-ja për mjekët që kanë kryer këtë punë. Nën

tre, pagesa e honorarëve nuk është bërë në bazë të atyre kritereve që i ngrit QKMF-ja, nën katër obligimi i honorarëve për vitin 2013 dhe tutje që nuk është bërë kurrë, edhe çka mendon drejtori për dyfishimin e shëndetësisë për vitin 2015, pra cilat janë projektet për shëndetësi, për ndryshimin e buxhetit”, nënvizoi kryetarja e Komitetit për Shëndetësi, dr. Berisha.

**Bedri Gashi**, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, tha se unë me kënaqësi e kam marrë ftesën për interpelancë dhe e përgëzoi Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për angazhimin dhe dëshirën e tyre për mbarëvajtjen e punës në shëndetësi dhe shtoi së ne kemi alternativa të shumta për të dalë nga kjo gjendje në të cilën gjendemi aktualisht. Nuk e di se Komiteti a është konsultuar me ju z kryesues rrëth procedurave që duhet të ndiqen për një interpelancë, sepse konsultimet me kryesuesin gjithherë janë të nevojshme, gjithashtu arsyeshmëria e interpelancës dhe dërgimi i pyetjeve në paket dhe i nderuari kryesues mua më kanë ardhur tri herë pyetjet ndaras. Kam dokumentin bazik që më ka ardhur për dy ditë të caktuara. E treta, nuk e di a është mangësi imja që i lexoj ligjet dhe i rilexoju shpesh. Në këtë rast kam lexuar LAP në të cilin thuhet se drejtori është këshilltar personali kryetarit dhe se nuk është i obliguar të marr pjesë në interpelanca. Mirëpo, për hir të vullnetit tim të mira dhe transparencës që dua ta kem para jush dhe me autorizim të kryetarit sot gjendem para jush. Kam një mori çështjesh të cilat përveç përgjigjeve në pyetjet parashtruara tuaja të që dua t'i ceku sot që janë të nevojshme në aspektin e tyre. Duke u pajtuar që të jem plotësisht në pajtim me ligjet, dhe rregulloret në fuqi për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në pajtim të plotë me Statutin e Komunës së Klinës, jam për të shkoqitur pyetjet dhe çështjet të parashtruara për sektorin e shëndetësisë. jam në këtë interpelancë për ligjet. Nëse qëllimi dhe synimi i kësaj interpelance është vërtetë për avancimin, mëkëmbjen e sektorit të shëndetësisë, e përgëzoj, e respektoj, dhe e çmoj lart çdo iniciativë, individë apo prioritet për punë të mirë që pretendon të ngreh në këmbë të shëndosha veprimtarinë dhe dinjitetin institucional e ligjor dhe menaxheria në komunën tonë”, pohoi ndër të tjera drejtori Gashi, i cili në vijim foli edhe për shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë për shëndetësinë klinase. “Unë e kam hartuar një dokument i cili fokusohet në zhvillimin e shëndetësisë. Më duhet të them se për gjendjen në QKMF ne kemi vërejtje edhe nga Ministria”, pohoi drejtori Gashi. Ai në vazhdim foli për punën që është bërë dhe që është duke u bërë, prej kohës kur ka ardhur në krye të kësaj drejtorie. “Sa i përket laboratorit unë do të debatoj këtë çështje me Kryetarin e Komunës dhe besoj se gjendja do të përmirësohet. Sa i përket sektorit të barnave unë kam informacione të plota për hyrje-daljet e barnave, ndërsa sa i përket vizitës që ka bërë Komiteti për Shëndetësi nuk kemi qenë të njoftuar as unë e as drejtori i QKMF-së, dr. Aliu”, shtoi ndër të tjera drejtori Gashi, i cili në vazhdim elaboroi edhe shumë çështje të tjera tematike.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se debati për interpelancë i nënshtrohen të njëjtave rregulla të diskutimit sikur i kemi ato në pikat e veçanta të rendit të ditës. Kryesuesi hapi debatin rrëth interpelancës.

**Fadil Gashi**, theksoi se disa sqarime kemi nevojë të na i jep drejtori dhe nuk hera e parë që kemi një drejtor në interpelancë para anëtarëve të KK, prandaj nuk është risi, por është që 15 vjet dhe është krejtësisht legale, legjitime. Dhe, sqarimi i dytë për drejtorin, nuk është që ka kërkuar opozita, por ka kërkuar një Komitet i ndërtuar prej këtij Kuvendi,

Komiteti për Shëndetësi, ata kanë kërkuar dhe na kanë prurë neve dhe ne si Kuvend e kemi pranuar, prandaj është Komiteti për Shëndetësi që ka kërkuar këtë interpelancë, jo opozita, por opozita ka anëtarë të vetin në atë komitet dhe kryesuesi i komitetit nuk është i opozitës, por ata kanë zgjedhur vetë atë kryesues. Përpjesën tjetër do të filloj nga fundi: U potencuan 700 pacientë me psikozë, për atë pjesë infrastrukturën ligjore po e sqaron drejtori, po i përkujtoj drejtorit se edhe ne analizojmë, edhe ne shfletojmë Ligjin për shëndetësi. Statusin e kësaj qendre e ka miratuar Kuvendi, statusin e saj që punon ky kuvend e ka hartuar dhe miratuar, edhe ne nuk jemi që ndërhyjmë në punën e njërit-tjetrit, kujtojmë që jemi në një kulm, si organe, si institucione, dhe asnje fjalë nuk u fol për shërbimet që i pranojnë qytetarët tanë në qendër. Madje me qiti për të dyshuar që QKMF-në a e menaxhon Ministria e Administratës Publike, apo e Shëndetësisë. Unë s'e di se cila ministri merret me këtë çështjen që potencoja drejtori. Ne e dimë që punëtorët e arsimi dhe ata shëndetësorë nuk janë shërbyses civilë, prandaj janë dy gjera të ndryshme dhe nëse është ai udhëzim i asaj ministrie ne si kuvend duhet ngritur zërin dhe duhet thënë se ajo ministri nuk ka të drejtë me interferuar me asnje letër, por edhe në qoftë ajo në punëtorët shëndetësorë. U potencua nga drejtori edhe fenomeni negativ që nuk punon laboratori, ne nuk po dimë për cilat fenomene dhe për cilat arsyen nuk punon. Nëse është shkaqe buxhetore është diçka tjetër, a kemi mundësi për ta ndihmuar për ta bërë funksional dhe kishte për të qenë më praktike kjo. Dy herë na përkujtoj qasjen në dokumente zyrtare, unë kujtoj se anëtarëve të KK nuk ka nevojë për t'ua thënë këto fjalë, sepse dokumentet zyrtare klasifikohen, cilat janë ato që s'mund të kenë qasje për qytetarët, ndërsa jo për anëtarët e Kuvendit, sepse anëtarët e KK janë pjesë e këtyre institucioneve. Ne nuk kemi armiqësi as më shëndetësinë, arsimin as me asnje drejtori, dhe këtu tërësisht kanë qenë 5 pyetje qysh i kam parë qysh i ka bërë KSH dhe ato 5 pyetje më mirë ka qenë për t'u parë në mënyrë të specifikuar cilat janë problemet dhe çfarë mund t'i ndihmojmë ne edhe DSH, edhe stafit, edhe gjithë punëtorëve të tjerë që merren me këtë veprimtari shëndetësore. Kjo do të kishte për të qenë ajo e përgjithshmjë, ajo e arsyeshmjë, ne për të qenë në shërbim të tyre, por jo kundër tyre absolutisht në asnje variant", nënvizoi anëtarë Gashi.

**Filloreta Berisha**, tha se falënderojmë drejtorin për këtë prezantim voluminoz që ka bërë, por jo i fokusuar në mënyrë konkrete në lidhje të pyetjeve, por më shumë në projekte të cilat synon për t'i realizuar si drejtor prej kur ka marrë punën. "Mendoj se drejtori ka një gatishmëri bukur të madhe për të bashkëpunuar dhe ka për qëllim për ta bërë ngritjen e mirëqenies së shëndetësisë në Komunën e Klinës. Si komision që kemi shkuar në vizitë ne nuk kemi nevojë për t'i kërkuar drejtorit a na lejon apo nuk na lejon për të shkuar në vizitë ndërsa jemi legjisacion dhe jemi komision i votuar nga ky Kuvend, ne të drejtë për të shkuar dhe kemi shkuar për të bërë diçka që mendojmë që kemi bërë për të mirën e qytetarëve të Klinës, që në bashkëpunim me drejtorin për ta bërë atë që është e mundur për t'i evituar ato të meta që janë aty. Është e vërtetë që atë ditë e kemi takuar drejtorin kur i numëruam ampulat dolën që 700 janë shpenzuar për një javë, që s'e dimë si janë shpenzuar dhe kush i ka shpenzuar. Qëllimi ynë është sot këtu se a dimë për të bërë ndonjë kthesë të madhe në shëndetësi se më të vërtetë gjendja është e rëndë. Qendrën emergjente atë ditë e kemi gjetur në gjendje tmerruese. Është në gjendje të rëndë, po trajtohet pacienti aty merr ndonjë infekzion. I kam parë vetë kutitë ku mbahen mjetet për sterilizim, kanë qenë tërësisht të ndryshkura, stelizatori nuk mbyllët, a e kanë marrë të ri, apo e kanë blerë të ri, uroj të jetë i tillë. Ne e dimë në çfarë kushtesh bëhet sterilizimi. E dyta, nuk ke fashë sterile, nuk ke mjete të punës sterile, nuk ke material që

të nevojitet në raste emergjente, nuk ke EKG, EKG-ja nuk ka punuar, sot ndoshta është duke punuar, atë ditë nuk ka punuar. Monitori nuk punon në emergjencë, qysh mund ta menaxhosh një pacient pa monitor, nuk ke mundësi ta menaxhosh. Mungesë e stafit aty, doktorët dalin në pauzë papasur orarin e pauzës. E kuptoj se drejtori ka qëllimin e mirë për arritje në shëndetësi por për momentin është gjendja tepër e rëndë dhe nuk është bëre një menaxhim i mirë i punëve. Ky është realiteti. Para dy muajve pacienti merr infuzion pa rryme elektrike me dritë të ajfonit, kjo është e vërtetë se kam qenë prezente aty në këtë rast. Realiteti është që një gjilpërë 5 cent del e blenë pacienti. Duhet të bëhet një menaxhim më i mirë, bile për raste emergjente të mos dal pacienti për të blerë jashtë, për raste të lehta është më normale për gjendjen në shëndetësinë në tërë Kosovën. Është e vërtetë që laboratori është në gjendje jo të mirë, rëntgeni po ashtu, pra po përsërisë gjendja është tepër alarmuese. Kjo është interpelanca që është thirrur nga komisioni jo që kemi dashur ta bëjmë këtë punë kaq të madhe, por problemi ka qenë se kjo gjendje është kështu”, pohoi dr. Berisha, e cila në vijim numëroi edhe shumë vërejtje dhe parregullsi të tjera që janë prezentë në shëndetësinë e Klinës.

**Arben Limani**, theksoi se drejtori për shëndetësi na pati premtuar se shumë shpejt do të na sjellë një plan për përmirësimin e gjendjes në shëndetësi.”A është fjala për këtë dokument që ia ke dorëzuar kryetarit, apo ka mbetur që ky plan të përgatitet më vonë?”

**Avni Gashi**, tha se këtu morëm shumë informata rreth shëndetësisë dhe u vërejt se në këtë fushë me shumë probleme po ballafaqohemi.”Unë do të ndalem te një problem më praktik që u ndal edhe drejtori i shëndetësisë, i cili preki shilingat, gjilpërat që mungojnë. Unë kisha një pyetje të thjeshtë: cilat janë ato barna që kanë mundësi të gjenden për cilindo pacient që vjen në QKMF, pra cilat janë ato barna që nuk ka nevojë për t'i blerë pacienti?- tha anëtarri Gashi.

**Qamile Qitaku**, tha se e mora fjalën jo për t'iu kundërvënë këtyre problemeve që kemi, mirëpo për disa sqarime që vërtet kur dihet fakti që shumica nuk e dinë organizimin në SHSH, përkatësisht gjendjen e mjekësisë familjare më shkurt. “Drejtori i potencioi gjitha punët që kryhen. Komiteti për shëndetësi i ka qitur pikat dhe ne i kemi diskutuar me drejtorin këto 5pika. Sa i përket emergjencës mund të them se aty nuk kemi pasur person përgjegjës në mungesë të mjeteve financiare. Tani për tani e kemi reduktuar diku tjeter dhe e kemi vendosur në emergjencë që në ato kushte që i kemi funksionon për mrekulli. Ka mungesë të materialit, sepse ato janë materiale shpenzuuese dhe ne brenda kornizave financiare duhet të veprojmë. Por tani e kemi në gjendje krejtësisht tjeter. Edhe ne kemi pasur dëshirë ta kemi një aparaturë moderne, mirëpo mundësitë janë këto ekzistuese. Me rëndësi që asnjë pacient nuk kthehet. Edhe letra në EKG nganjëherë na bën pengesë, sepse është material që shpenzohet në vazhdimësi. I dimë të gjitha çfarë janë mundësitë financiare dhe cilat janë procedurat e furnizimit me barna dhe material shpenzuues. Prandaj, jemi këtu ku jemi dhe nuk duhet pritur mrekullia në shëndetësi papasur ligjin për shëndetësi. Atë duhet ta kemi të qartë, se nuk mund të ndodhin mrekullia brenda natës. Pastaj, mospagesa e kujdestarisë, kujdestaritë e natës gjithherë paguhen, mund të jetë eventualisht një muaj me vonesë, mirëpo gjithherë janë paguar. Te pagesa e doktorëve është diçka tjeter, është marrëveshje interne që është edhe ligjore, e di që çdo herë kur ka mungesë financiare, pra në mungesë të pagesës financiare që t'ju jepet ditë e lirë. Edhe nga këta çdo njëri kanë shfrytëzuar ditë të lirë. Stafi

menaxhues nuk ka asnje borxh ndaj atyre individeve. Ju mund te keni qasje edhe ne dokumentacionin zyrtar cka komisioni ka mundur ta kerkoje, mirépo ne asnje borxh sa i perket kujdestarive nuk e kemi. Pagesa e honorarëve, aty ka kritere, kujdestarite e natës janë kritere, deri ne ora 10 llogaritet punë e ditës, ndërsa prej orës 10, çdo orë llogaritet honorar dhe pagesa e punës së natës eshtë më e shtrenjtë. Ne i kemi disa standarde prej MSH se cka duhet per te publikuar dhe cka jo”, pohoi anëtarja Qitaku, e cila ne vijim foli edhe rreth ruajtjes së dokumentacionit, buxhetit, laboratorit, çeshtjen e barnave etj. ”Ne kemi nevoje për ndihmë financiare. Materniteti eshtë punë shtesë për QKMF-në, aty bëhen shpenzime enorme. I kemi dy motra dhe ato janë me diploma baçelar, ashtu ministria e ka komentuar, ne nuk jemi fajtorë, ata janë kompetentë, eshtë ne pyetje koeficienti, plus puna e natës, ashtu kanë vendosur, ne nuk mund te bejmë asgjë. Kam kerkuar edhe më herët që ne kemi nevoje për te na ndihmuar, mirépo s'e di pse nuk e keni shfaqur atë gatishmëri. Kam kerkuar që ta kem edhe si pikë te rendit te ditës nuk ka treguar askush gatishmëri për te përkrahur në atë drejtim. Duhet vërtetë te ndihmohet shëndetësia, sepse nuk eshtë vetëm e stafit apo drejtorit, por e krejt komunës së Klinës. Nëse duam ta kemi një shëndetësi të mirëfilltë ajo edhe duhet te ndihmohet”, shtoi anëtarja Qitaku e cila edhe ne vijim potencoi disa çeshtje që lidhen me QKMF-së dhe shëndetësinë përgjithësisht, si çeshtjen e higjenës, monitorit etj. ”5 mijë vizita, 95 mijë shërbime për gjashtë muaj mendoj që nuk eshtë pak”, nënvisozi anëtarja Qitaku.

Haxhi Ibishi, foli rreth disa çeshtjeve debatuese. ”Realisht krahas defekteve që përcjellin shëndetësinë, aty ka edhe punë, edhe eshtë i vetmi sektor që punon 24 orë, eshtë sektori që për 24 orë ballafaqohemi me gjithçka, siç themi ne ”sëmundje te ftohta”, ose raste te ftohta që realisht duan një tretman profesional, por kemi edhe raste kur janë te ”nxehta”, te cilat realisht kanë një tretman aty për aty. Kлина nuk i ikë defektit nacional te shëndetësisë, nuk mendoj që Kлина ka hapa mbrapa ne komplet ne skemën që eshtë nationale, por shëndetësinë nationale e ngërthejnë edhe dy çeshtje problematike që edhe ato reflektohen ne komuna. E para, decentralizimi financiar, i cili nuk ekziston. Rreth barnave ekziston lista esenciale e cila mbulohet me tender nacional, jo me tender lokal, jo me prokurim lokal. Prandaj edhe këtu edhe janë defektet se adresa jonë, kérkesat tonë shkojnë drejtim te një strukture tjeter barnash, atëherë ata servojnë barna që ndoshta neve nuk na hynë ne punë. Për çeshtjen e dytë që thashë, që e lëngon shëndetësia, çeshtja e kuadrit, edhe këtu eshtë problemi, se ne çeshtjen e kuadrit po ekziston kérkesa bazike që eshtë për preventivë për primaren, kurse neve ne nivelin nacional na lejohen specializimi suplementar. Kлина ka nevoje për primaren ku hynë: mjeku i mjekësisë familjare, mjeku pediatër, mjeku i preventivës që eshtë epidemiologu, higjenisti, radiologu dhe laboratori, kurse përjashtohen te gjithë sektorët tjerë profesionalë. Kemi pasur një fat te madh që kemi njerëz që nuk i ka Dukagjini dhe thjesht ne e kemi shfrytëzuar atë kapacitet te atyre njerëzve tanë dhe mendoj që janë disa shërbime që kryhen ne Klinë dhe na kanë lakmi edhe regjionet tjera”, theksoi kryesuesi Ibishi, i cili foli pranoi se ka edhe probleme reale, sepse eshtë një sektor që punon 24 orë. Ne vijim kryesuesi ne vijim dha sqarime edhe për shumë çeshtje te tjera, si dallimit ne mes te kartotekës dhe arkivës. ”Kartoteka eshtë ruajtur dhe ruhet, që janë dy lloje kartotekash, e vaksinimit dhe gjenerale, te cilat janë te paprekshme. Jam i vetëdijshëm se shëndetësia eshtë sfidë, Kryeministri i Kosovës, edhe për mandatin e ardhshëm e ka vendosur që një prej sidave nationale te Kosovës te jetë shëndetësia. Dhe mendoj që krahas kësaj sfide, Kлина me kryetarin Bashota, do t'i përgjigjet kësaj sfide. Edhe Komisioni e ka bërë këtë kérkesë për interpelancë, që nuk ka asnje paragjykim dhe

mendoj që nuk kanë pasur as tendencë individuale as institucionale”, konstatoi kryesuesi Ibishi.

**Agron Bacaj**, tha se para është e përkrahim komisionin për shëndetësi dhe mendoj që komisionet që janë formuar nga AK ta kryejnë punën e tyre, gjitha komisionet t’i ftojnë drejtorët për t’i shfaqur problemet. “E dyta, nuk besoj që drejtori i DSH është përgjegjës për gjendjen në shëndetësi, kjo gjendje është e trashëguar, e dimë se këtë gjendje e kemi pasur në vijimësi. Kjo gjendje nuk është e shkaktuar vetëm në nivelin lokal, por defekte qëndrojnë edhe në nivelin qendror. Mendoj që këto problematika që gjenden shëndetësia duhet të gjejmë rrugët se si mund të zgjidhen. Shëndetësia ka nevojë për një ndarje prej sektorit privat dhe atij publik, sepse këtu po lindin problemet që po na përcillen në vazhdimësi. Mendoj që drejtori, edhe drejtoria dhe QKMF-ja e dinë që janë shumë defekte që gjinden në shëndetësi mund të zgjidhen nëse kanë pak vullnet pak më shumë”, theksoi anëtari Bacaj i cili në vijim prezantoi edhe probleme dhe çështje të tjera që lidhen me shënuesi, si skadimin e afatit të barnave, që sipas tij barnat skadojnë fatet, ndërsa popullata ballafaqohet me mungesë të barnave, pastaj të punësuarit pa kontrata, që sipas tij me ligjet e punës ky defekt mund të evitohet prej drejtorisë, përkatësisht edhe QKMF-së. “Nuk ka nevojë askush të punojë pa kontrata dhe pa ligje të punës dhe po ashtu nuk ka nevojë askujt për t’iu qitur pagat nëpër xhirologari me ia marrë njërit nga xhirologaria e për t’ia bartur tjetrit punëtor në dorë. Këto janë defekte që kanë ndodhur dhe ndodhin në mjekësin familjare dhe duhet të evitohen. Edhe mjekët e kanë një betim të Hipokritit aty, mendoj që ata duhet për ta jetësuar në praktikë,” nën vizori anëtari Bacaj i cili në vijim shtroi edhe shumë çështje tjera që lidhen me shëndetësinë klinase dhe kërkoi eliminimin e defekteve që lëngojnë shëndetësinë e Klinës dhe në fund theksoi se mendoj që hapat që ka ndërmarrë drejtori i DSH kanë për t’u përkrahur nga këtu dhe të gjithë duhet të angazhohemi që gjendjen e shëndetësisë në Komunën e Klinës për të përmirësuar”, ka konstatuar anëtari Bacaj.

**Avni Gashi**, theksoi se desha të jemi konciz me pyetjen që i bëra drejtorit dhe kërkova përgjigje për ta ditur edhe qytetarët e Klinës se cilat barra i kemi aty? “Është një pyetje e thjeshtë dhe shumë konkrete: ”A ka një bar që ekziston në QKMF, që neve na duhet apo të gjitha janë me afat të skaduar. Edhe diçka, besoj që i takon drejtorit i cili ka nxjerrë një udhëzim ku thuhet se do të ngritën sanksionet ndaj atyre mjekëve të cilët nuk gjenden në vendin e punës. U dëshmua nga të gjithë këtu se herë pas here nuk gjenden mjekët që duhet të janë në zyra, këtë e dëshmon edhe komisioni që ka shkuar në ora 11.30 minuta dhe nuk ka gjetur mjekë duke punuar. Pra, a ka ndëshkuar, përkatësisht a ka sanksionuar drejtori aktual ndonjë mjek që nuk është gjendur në orarin e punës gjatë kësaj periudhe 6 mujore, çështje që nuk ka të bëjë me nivelin qendror, por ka të bëjë me menaxhimin e punëtorëve në QKMF. Dhe e treta që ka të bëjë pak a shumime nivel qendror, që ka të bëjë me pyetjen e pestë: çka mendoni me ”dyfishimin”, është fjala, çka mendoni për ndryshimin e buxhetit për vitin 2014/2015. Në këtë rast dua ta potencojë që Ligji mbi sigurimet shëndetësore sipas informatave që kemi përmes medieve thuhet se me 1 janar 2015 do të hynë në shërbim, a do të ketë ndikim direkt edhe në buxhet, nëse ky ligj hyn në fuqi, sepse në të njëjtën kohë kur ne ballafaqohem me probleme elementare parashihet që në vitin 2016-2017 të blihet edhe një rëntgen që do të kushtojë 150 mijë euro, ndërsa gjerat elementare neve na mungojnë”, konstatoi anëtari Gashi.

**Enver Gashi**, tha se unë dua të ndalëm në QMF në Sferkë.”QMF në Sferkë është në gjendje jo të mirë, kurse shqetësim kryesor është mungesa e ilaçeve esenciale, pastaj në ambulancë nuk ka asnje pikë ujë etj. “Një pyetje kam për drejtoren: pse kur doktori i ambulancës në Sferkë nuk dërgoni asnje zëvendësim, ku mbi 6 mijë banorë mbesin pa përkujdesje mjekësore”, shtoi anëtari Gashi.

**Tunë Dedaj**, tha se si qytetar më ka rënë shpeshherë të gjendem në emergjencë në shtëpinë e shëndetit dhe asnjeherë nuk kam gjetur barnat që është dashur për t'i gjetur. “Do të thotë nëse një sëmurje është e rëndë, do të thotë pacienti nuk ka pare për të blerë ilaçin në barnatoret private, ai aty nuk mund të marr asnje ndihmë përpos mjekut që e viziton me dëgjuese. Unë kisha kërkuar që të kishim mundësi, përkatësisht më shumë kisha kërkuar nga kryetari i Komunës që të angazhohet që në urgjencë së paku barnat elementare të jenë gjithmonë aty. Më lind dyshimi që ato barna, ato ilaçe çohen në barnatoret private edhe shiten për së dyti. Ndërsa sa i përket orarit të mjekëve, sot kemi shumë mjekë të papunë, këtyre mjekëve t'u thuhet “stop” në dy vende pune, pra edhe në SHSH edhe në ordinancë private. Arsyja është se ata nuk rrinë në orar të punës, se atje t'i merr 10 euro-15 euro privat. Kështu si kërkesë kam që kryetari të shfrytëzojë autoritetin e tij dhe kërkoj që brenda këtyre 2-3 viteve ta vë në binarë shëndetësinë”, theksoi anëtari Dedaj.

**Filloreta Berisha**, tha se desha vetëm një sqarim për Qamilen, nuk thashë që ka pastërti në laborator as në QKMF, por me të vërtetë unë e kuptoj se është një tualet aty që shërbehen edhe qytetarët që shkojnë, por nuk është e pastër dhe është shumë e ndotur. “Ai pacient ka për të shkuar për ta dhënë urinën aty, edhe ai në vend që të bëjë mirë diçka për vete, ai merr edhe një infeksion. Nuk po them për t'u keqinterpretuar, mirëpo për ta parandaluar diçka që kemi mundësi për ta bërë dhe është mirë për ta bërë. Rreth çështjes së barnave, pse skadohet afati i branave, afati i atyre barnave skadohet, sepse asnje pacient nuk dërgohet në barnatoret për të marrë barin adekuat që është në listën esenciale dhe ai detyrohet që të njëjtin bar të shkojë për ta blerë në barnatoret private ndoshta veç me emër të ndryshëm. Këtu është problemi, për atë edhe skadon afati i tyre dhe nuk shkon askush për t'i marrë. Ose ka qytetarë që nuk dinë që ekzistojnë barna fare në barnatoren e QKMF-së. Problemi tjetër te monitori, monitori është e vërtetë që funksionon, por nuk ke elektroda që lidhen për trup, për lëkurën. Ajo kushtin 10 centë një, për atë arsyë është jashtë funksionit. Janë disa gjera shumë elementare që kushtojnë shumë pak që mund të funksionojnë dhe për t'iu lehtësuar punën stafit. Askush nuk ka për qëllim për ta lënduar asnje mjekë, sepse e dimë qysh kanë punuar edhe më herët edhe tash edhe krejt. Por askush nuk mund ta di qysh mund të funksionojë një mjek kur e ka aparaturën, 90 për qind të punës ia kryen aparatura dhe ajo është funksionale”, konstatoi dr. Berisha.

**Bedri Gashi**, tha se sa i përket publikimit të honorarëve, unë personalisht e kam bërë publikimin e tyre, ndërsa sa i përket orarit të punës është e vërtetë se orari i punës nuk respektohet si duhet dhe ju siguroj se asnje punëtor nuk do të jetë pa kontratë pune. “Sa i përket emergjencës ajo duhet të ketë një autonomi, edhe sipas LVL-së dhe parashihet që ndarja e emergjencës nga QKMF-ja të bëhet në vitin 2015. Mund të them se ka kthesa pozitive, gjegjësisht janë marrë hapat e duhur në përmirësimin e gjendjes. Sa i përket pyetjes për mospagesën e punës së natës, mund t'ju them së unë prej se kam

ardhur në këtë sektor puna e natës është paguar, ndërsa sa i përket pagesës së honorarëve mendoj ka transparencë të plotë. Një pyetje tjetër është: Pse motra medicinale merr pagën më të lartë në QKMF? “Kemi një titull të ri të punës në bazë të Udhëzimit nga Ministria e Pushtetit Lokal “mami e lartë” me koeficient 7-të, që d.m.th. se nuk ka paligjshmëri”, sqaroi drejtori Gashi. Pyetje tjetër: Cilat janë projektet në shëndetësi?-drejtori Gashi shtoi se investimet kapitale janë paraparë për vitet e ardhshme, parashihet ndërtimi i një objekti për rehabilitimin e personave me psikozë që në Komunën tanë për tanë janë identifikuar 750 persona me psikozë. Sa i përket barnave e kemi bërë një inspektim nëpër barnatore dhe kemi konstatuar shumë parregullsi, kemi hasur barna me afat të skaduar e tjera”, shtoi drejtori Gashi, i cili në vijim foli edhe për shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë rrëth ecurive në shëndetësinë e Komunës së Klinës, të arriturat, vështirësitet, synimet, priorititetet etj.

**Filloret Berisha**, tha se unë mendoj se Urdhëresa Administrative për ngritjen e koeficientit është dashur të vijë nga Ministria e Shëndetësisë.

**Avni Gashi**, pyeti se cilat barna duhet me blerë pacientet?

**Arben Limanaj**, tha se në një nga mbledhjet e Kuvendit, Ju z. Drejtor, keni premtuar se do të na ofroni planin e punës dhe ende nuk e kemi atë plan.

**Qamile Çitaku**, tha se ne së bashku me drejtorin i kemi analizuar shqetësimet e shprehura nga Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe shtoi se ne ende nuk e kemi Ligjin për Shëndetësi, e mungesa e tij na krijon probleme, pagesa e honorarëve bëhet në bazë të kritereve dhe tha se materniteti është një barrë shumë e madhe për QKMF-në.

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha së ky sektor punon 24 orë pa ndërprerje dhe tha se kemi mjekë të profileve të ndryshme, por decentralizim financiar në shëndetësi nuk ka .

**Agron Bacaj**, i dha përkrahje Komitetit për Shëndetësi dhe theksoi se gjendja në shëndetësi është trashëguese. “Mendoj se duhet të ndahet sektori privat dhe ai publik dhe duhet të gjithë të angazhohemi që t’i eliminojmë disa çështje negative”, shtoi anëtari Bacaj.

**Pika e X-të : Të ndryshme.**

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha se siç e ceka edhe në fillim të seancës bëhet fjalë për zëvendësimin e një anëtari të Komisionit për emërtimin e vendbanimeve dhe është propozuar që në vend të Enver Marmullakut në këtë komision të emërohet Hajdin Morina. Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

**Ky propozim u miratua unanimisht nga anëtarët e Kuvendit.**

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Procesmbajtësi,  
Beqir Gashi



Kryesuesi i Kuvendit,  
Dr. Haxhi Ibishi